

I FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

MESACOR

Tableta të veshura me film - 20 mg
(Olmesartan medoksomil)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Mesacor dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Mesacor
3. Si ta merrni Mesacor
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Mesacor
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË MESACOR DHE PËRSE PËRDORET

Mesacor përmban substancën aktive olmesartan medoksomil, i cili është një antagonist i receptorëve të angiotenzinës - II me veprim të ngjashëm me atë të losartanit.

Mesacor përdoret në kontrollin e hipertensionit.

2. PËRPARA SE TË MERRNI MESACOR

Mos merrni Mesacor nëse:

- vuani nga çrregullime të rënda të veshkave,
- vuani nga çrregullime të rënda të mëlçisë,
- jeni në tremujorin e dytë dhe të tretë të shtatzënisë,
- jeni duke ushqyer fëmijën me gjë,
- keni obstrukcion biliar.

Tregoni kujdes të veçantë me Mesacor

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Mesacor nëse keni:

- mbindjeshmëri ndaj olmesartan medoksomilit ose ndaj përbërësve të tjerë të tabletave Mesacor;
- stenoze të arteries renale;
- stenoze të aortës ose të valvulës mitrale;
- kardiomiopati hipertrofiqe.

Këshillohet monitorimi i përqëndrimit të kaliumit në gjak, sidomos në të moshuarit dhe në pacientët me çrregullim renal; në këta pacientë mund të jenë të përshtatshme doza fillestare të vogla. Pacientët me aldosteronizëm primar dhe Afro – Karaibianë (sidomos ata me hipertrofi të ventrikulit të majtë), mund të mos përfitojnë nga efekti i antagonistëve të receptorëve të angiotenzinës – II.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Mesacor. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Mesacor në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit, sidomos këta të mëposhtmit:

- kripërat e kaliumit, sepse rrisin rrezikun e hiperkalemisë;
- ciklosporina, sepse rrit rrezikun e hiperkalemisë;
- diuretikët (diuretikët kursyes të kaliumit dhe antagonistët e aldosteronit) sepse stimulojnë efekt hipotensiv dhe rrisin riskun e hiperkalemisë;
- litiumi, sepse eliminimi i tij reduktohet nga antagonistët e receptorëve të angiotenzinës – II.

Shtatzënia dhe ushqimi me gjë

Mesacor duhet të shmangët gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë.

Mesacor kundërpikohet gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të shtatzënisë.

Mesacor nuk rekomandohet gjatë ushqimit me gjë.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Mesacor ka një ndikim të vogël ose të moderuar në aftësinë për të drejtuar automjetin. Në disa raste, në pacientët që marrin terapi antihipertensive, Mesacor shkakton marrje mendsh ose lodhje, të cilat mund të çrregullojnë aftësinë për të reaguar.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Mesacor

Ky bar përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI MESACOR

Gjithmonë Mesacor merret ekzakhtësisht si ju thotë mjeku juaj. Duhet të konsultoheni me mjekun ose me farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt. Mesacor merret nga goja për trajtimin e hipertensionit. Pas dozës së parë, efekti hipotensiv zgjat për 24 orë. Efekti hipotensiv është i dukshëm brenda dy javësh nga fillimi i terapisë dhe është maksimal brenda 8 javësh.

Në fillim të terapisë përdoren 10 mg olmesartan medoksomil një herë në ditë. Në qoftë se është e nevojshme, doza rritet në 20 mg një herë në ditë; maksimumi është 40 mg në ditë.

Në pacientët me çrregullim renal, nuk rekomandohet përdorimi i Mesacor në çrregullimin e rëndë renal (kur klirensi i kreatininës është nën 20 mL/min.) duke qenë se përvoja është e limituar, dhe doza maksimale në çrregullimin nga i lehtë në të moderuar (kur klirensi i kreatininës është 20 deri në 60 mL/min.) është 20 mg në ditë.

Në mënyrë të ngjashme, në pacientët me çrregullim hepatic, nuk rekomandohet përdorimi i Mesacor në çrregullimin e rëndë hepatic duke qenë se nuk ka përvoja të tilla. Pacientëve me çrregullim hepatic të moderuar duhet t'i jepet një dozë fillestare prej 10 mg në ditë dhe doza maksimale është 20 mg në ditë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Mesacor

Në qoftë se keni marrë më shumë Mesacor se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Mesacor

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë dozë), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.

Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Mesacor mund të shkaktojë efekte anësore, të cilat janë zakonisht të lehta, megjithëse jo çdokush i manifeston. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:

- hipotension simptomatik ku përfshihet marrja e mendve, kryesisht në pacientët me reduktim të vëllimit intravaskular (p.sh. pacientët që marrin doza të larta të diuretikëve);
- me raste mund të ndodhë hiperkalemi;
- të zakonshme: çrregullime gastro – intestinale, dhimbje krahore, edemë periferike, hipertrigliceridemi, lodhje, simptoma të ngjashme me ato të gripit, kollë, faringit, rinit, infeksion i traktit urinar, hematuri, hiperuricemi, artrit, dhimbje të muskujve dhe të skeletit;
- më pak të zakonshme: anginë, vertigo, rash;
- shumë të rralla: dhimbje koke, trombocitopeni, mialgji, prurit, urtikarie.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI MESACOR

Mbajeni larg fëmijëve.

Mos e përdorni Mesacor pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim. Ruajeni në temperaturë nën 25°C. Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga dielli dhe nga lagështia.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë Mesacor – Tableta të veshura me film 20 mg

Lënda vepruese është olmesartan medoksomil.

Çdo tabletë e veshur me film përmban 20 mg olmesartan medoksomil.

Përbërës të tjerë: laktozë monohidrat, celulozë mikrokristalore, hidroksiipropilcelulozë, stearat magnezit, acid stearik, dioksid silici koloidal, Opadry II i bardhë.

Përmbajtja e paketimit:

kuti kartoni me 30 tableta të veshura me film.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:



Sipas recetës së mjekut.



Barin nuk mund të merret gjatë shtatzënisë.



Përmbajtja.



Kujdes.



Forma e tabletës.



Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00355 4 2362800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u formulua në Tetor 2014.

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm